



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KUVENDI

Komisionit të Posaçëm Parlamentar “Për reformën administrativo-territoriale në Republikën e Shqipërisë”

Nr 364 Prot

Tiranë, më 26.1. 2026

DREJTUAR: Z. Niko Peleshi

KRYETAR I KUVENDIT TË SHQIPËRISË

OBJEKTI: Kërkesë e Komisionit të Posaçëm Parlamentar “Për reformën administrativo-territoriale në Republikën e Shqipërisë” për ndryshimin e Vendimit të Kuvendit nr.75/2025 datë 27.10.2025 dhe vendimit nr 98/2025“

BAZA LIGJORE: Nenet 77 pika 1, 78 e Kushtetutës dhe 24, 55 të Rregullores së Kuvendit

I nderuar Zoti Kryetar,

Në bazë të neneve 77 dhe 78 të Kushtetutës dhe 24, 55 të Rregullores së Kuvendit, Ne deputetët e Komisionit të Posaçëm Parlamentar “Për reformën administrativo- territoriale në Republikën e Shqipërisë ”

kërkojmë:

Ndryshimin e Vendimit nr.75, datë 27.10.2025 “Për ngritjen e Komisionit të Posaçëm Parlamentar “Për reformën administrativo-territoriale në Republikën e Shqipërisë” dhe vendimit nr. 98 date 6.11.2025 “ Për një shtesë në Vendimi nr.75, datë 27.10.2025 “Për ngritjen e Komisionit të Posaçëm Parlamentar “Për reformën administrativo-territoriale në Republikën e Shqipërisë”

Komisioni i Posaçëm synon që nëpërmjet një qasje gjithëpërfshirëse dhe transparente të drejtojë dhe koordinoj një proces reformimi me synimin:

- a) të shqyrtojë kuadrin ligjor dhe institucional të qeverisjes vendore;
- b) të analizojë dhe propozojë opsione për ridizenjimin territorial dhe forcimin e kapaciteteve administrative të njësive të qeverisjes vendore;

- c) të vlerësojë sistemin e financave vendore dhe të propozojë masa për decentralizimin fiskal;
- ç) të shqyrtojë cilësinë dhe aksesin e shërbimeve publike vendore;
- d) të sigurojë përputhshmërinë e propozimeve me acquis të Bashkimit European dhe politikat e kohezionit rajonal;
- dh) të zhvillojë proces konsultimi tërësor, gjithëpërfshirë dhe transparent me njësitë e qeverisjes vendore, shoqatat e tyre, shoqërinë civile dhe partnerët ndërkombëtarë;
- e) të paraqesë përpara Kuvendit dokument analitik me rekomandime për hapat e mëtejshëm dhe projekt-propozime ligjore.

Reforma administrativo-territoriale përbën një nga prioritet kyçe të programit të mazhorancës parlamentare Shqipëria 2030 dhe të integritit në BE.

Që prej krijimit të Komisionit janë parashikuar dhe njoftuar zyrtarisht mbledhje në datat 11.11.2025, 27.11.2025, 17.12.2025 dhe 22.01.2026.

Në mbledhjen e parë të datës 11.11.2025 nuk kanë marrë pjesë përfaqësuesit e Partisë Demokratike, por vetëm ata të Grupit Parlamentar Aleanca për Ndryshim dhe të Grupit Parlamentar i Partisë së Lirisë. Në këtë mbledhje Komisioni u konstituua formalisht dhe përfaqësuesit e Partisë Socialiste i bënë thirrje për pjesëmarrje dhe angazhim të Partisë Demokratike.

Në mbledhjen e dytë të datës 27.11.2025 kanë qenë prezent të gjithë anëtarët e Komisionit. Në këtë mbledhje u miratuar plani i punës dhe struktura e ekspertëve. Vendimi për emërimin e Sekretarit të Komisionit u shty për mbledhjen e rradhës.

Mbledhja e parashikuar në datën 17.12.2025 nuk u zhvillua për mungesë të kuorumit, pasi asnjë përfaqësues i opozitës nuk u paraqit, pavarësisht njoftimit të rregullt. Gjithashtu edhe në mbledhjen e rradhës të datës 22.01.2026 nuk ka qenë prezent asnjë përfaqësues i opozitës, pavarësisht njoftimit të rregullt.

Për rrjedhojë, që prej krijimit të Komisionit në datën 27.10.2025 (gjatë një periudhe dy mujore) nga 4 mbledhje të njoftuara rregullisht vetëm një mbledhje është zhvilluar me përbërje të plotë të opozitës. Referuar vendimit të Kuvendit, kohëzgjatja e punës së Komisionit është parashikuar 9 muaj. Kjo kohëzgjatje është dakordësuar duke patur parasysh rëndësinë e miratimit të reformës administrative-territoriale në kohë, pra 1 vit përpara zhvillimit të zgjedhjeve vendore 2027 në mënyrë që të merren masat përkatëse ligjore, administrative dhe organizative.

Nisur nga qasja e bojkotuese e opozitës parlamentare si dhe fakti që reforma administrative-territoriale përbën një nga prioritetet kyçe të programit të mazhorancës parlamentare Shqipëria 2030 dhe për integritimin në BE, propozohet ndryshimi i përbërjes dhe mënyrës së punës së Komisionit.

Si rrjedhojë, propozohet që pika III e Vendimit të ndryshohet më këtë përmbajtje:

Komisioni i Posaçëm përbëhet nga 17 anëtarë, nga të cilët 9 janë janë përfaqësues të Grupit Parlamentar të Partisë Socialiste dhe 6 përfaqësues të Grupit Parlamentar të Partisë Demokratike, 1 përfaqësues i Grupit Parlamentar Aleanca për Ndryshim dhe 1 përfaqësues i Grupit Parlamentar i Partisë së Lirisë.

Në këtë mënyrë, i çelet rruga avancimit të reformës në përputhje me planin e punës të miratuar, së bashku me votat e opozitës parlamentare, në mbledhjen e datës 27.11.2025.

Më tej, propozohet që pika IV e Vendimit ndryshohen me këtë përmbajtje:

Kryetari i komisionit është përfaqësues i Grupit Parlamentar të Partisë Socialiste dhe zëvendëskryetari është përfaqësues i Grupit Parlamentar të Partisë Demokratike.

Ju faleminderit,

DEPUTETËT

- ① Arbija Hoxhiku
- ② Jalona Gjylkeushi
- ③ ERMAL E UÇI
- ④ Klevis Jahaj
- ⑤ Marijana Duceku
- ⑥ Blendi Kleani
- ⑦ Vasil Shari
- ⑧ Ermel Pacesi
- ⑨ Tomar Zuka
10. DAKUNAN GJILHOR